

VENDIM
Nr.33, datë 23.12.2009

PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHITJES SË UJIT MË SHUMICË
(KOMUNA KOLSH) PËR SHAUK, LEZHË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU- së

VENDOSI:

1. Të miratojë për SHAUK Lezhë:
- tarifën e shitjes së ujit me shumicë: 26 lekë/m³.
2. Komuna Kolsh do të kryejë faturimin në zonën e saj të shërbimit me tarifa jo më të larta se tarifat (sipas llojit të klientëve), e miratuara nga Enti Rregullator i Ujit për SHAUK, Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2010 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi